



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

V E N D I M

Nr.92 Datë 24 . 11. 2008

Mbi

“Transaksionin e realizuar nëpërmjet shitblerjes të pjesëve prej 20% të kapitalit në shoqërisë Antea Cement Sha, respektivisht nga BERZH dhe IFC”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e :

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Perpali Zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24 . 11.2008, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Njoftimin e transaksionit të realizuar nëpërmjet shitblerjes të pjesëve prej 20% të kapitalit në shoqërisë Antea Cement Sha, respektivisht nga BERZH dhe IFC

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, neni 56, neni 25 i Rregullores “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të informacionit të Sekretariatit mbi njoftimin e transaksionit të realizuar nëpërmjet shitblerjes të pjesëve prej 20% të kapitalit aksionar në shoqërinë Antea Cement Sh.a, respektivisht nga 20% secila prej institucioneve ndërkombëtare investuese, BERZH dhe IFC.

V Ë R E N S E:

1. Palët e përfshira në mënyrë të drejtëpërdrejtë në transaksion:

Nga njëra anë:

- **Titan Cement SA**, një shoqëri anonime e themeluar dhe që funksionon sipas legjislacionit të Greqisë (**Sponsori**);
- **ALVACIM LIMITED**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara e themeluar dhe që funksionon sipas legjislacionit të Qipros (**Sponsor Holdco**);
- **ANTEA CEMENT Sh.a**, një shoqëri aksionere e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit shqiptar për shoqëritë tregtare, me seli në Tiranë, Shqipëri, me numër regjistrimi 36120 datë 07.07.2006.

dhe

Nga ana tjetër:

- **BERZH**, është një bankë multilaterale e themeluar në bazë të një traktati ndërkombëtar në maj të vitit 1990, me qendër në Londër. Shqipëria është anëtare e kësaj banke qysh prej vitit 1991.

-**IFC**, është organizatë internacionale e themeluar në vitin 1956, nga marrëveshja ndërmjet shteteve anëtare të saj. Shqipëria është anëtarësuar në IFC, në Tetor të vitit 1991.

BERZH dhe IFC, janë investitorë strategjikë, që nuk kanë qëllim të kontrollojnë tregun. Synimi i tyre është aktivizimi dhe nxitja e kapitalit të huaj dhe vendas, përsa i përket krijimit, përmirësimit dhe zgjerimit të veprimtarive ekonomike në sektorin privat, krijimi i një mjedisi sa më konkurrues. BERZH dhe IFC nëpërmjet investimeve dhe financimeve frytdhënëse në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, përfshirë edhe sektorët e shërbimeve dhe ato financiarë, mbështetjet nismat e sipërmarrjes private, duke rritur kështu konkurrueshmërinë në treg.

2. Palët kanë rënë dakord me anë të Marrëveshjes së Aksionerëve për blerjen e pjesëve prej 20% të kapitalit aksionar të shoqërisë Antea Cement Sh.a nga secila prej institucioneve ndërkombëtare të investimit BERZH dhe IFC.

3. Si rrjedhojë e pjesëmarrjes në kapitalin themeltar institucionet investuese përfitojnë edhe pjesëmarrja jo influencuese në

vendimmarrje ku përfshihen të drejtat për: (i)amendimin e statutit të shoqërisë, (ii)rritjen e kapitalit, (iii) shitjen e shoqërisë, (iv) listimin e aksioneve të saj në bursë dhe (v) likuidimin vullnetar të shoqërisë.

4. Një pjesëmarrje prej 20% për secilin nga institucionet investuese në kapitalin aksionar të shoqërisë, në kuptim të nenit 10 të Ligjit Nr 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, nuk mundëson përfitim të kontrollit influencues në shoqërinë Antea Cement SHA.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, nenit 25 të Rregullores “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”.

VENDOSI:

1. Të mos klasifikojë “njoftimin e transaksionit të realizuar nëpërmjet shitblerjes të pjesëve prej 20% të kapitalit në shoqërisë Antea Cement Sha, respektivisht nga BERZH dhe IFC” si përqendrim në kuptim të nenit 10 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Përpali

(_____)
Zv/Kryetar

Servete Gruda

(_____)
Anëtar

Koço Broka

(_____)
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R